

KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH

NDERMJET

- Z. Arben Mertiri
- Z. Arben Nazeraaj
- Z. Artan Zhupani
- Z. Armando Dimo

Bashkarisht si SHITESIT

- Z. Niklovan Çela
- Z. Bledar Çela
- Z. Fatjon Latifi
- Z. Eris Kerçuku

Bashkarisht si BLERESIT

Date: 02/10/2018



KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH

Sot me date 02/10/2018, palet e meposhtme nenshkruajne kete Kontrate Shitblerjeje te Kuotave, ne perputhje me Kodin Civil te Republikes se Shqiperise dhe Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar.

SHITESIT:

Z. Arben Mertiri, shtetas shqiptar, lindur më 14.02.1970, në Bubullinë, Lushnje, banues në Kolonjë, Lushnje, mbajtës i kartës së identitetit nr. 025511983, ne cilesine e Ortakut qe zoteron 1 kuote qe korrespondon me 40% te kapitalit te regjistruar te shoqerise Entertajni sh.p.k.;

dhe

Z. Arben Nazeraaj, shtetas shqiptar, lindur më 12.11.1966, në Vreshtas, banues në adresën: Lagjia Kastriot, Rruga Anton Profka, Fier, mbajtës i kartës së identitetit nr. 033013327, ne cilesine e Ortakut qe zoteron 1 kuote qe korrespondon me 20% te kapitalit te regjistruar te shoqerise Entertajni sh.p.k.;

dhe

Z. Artan Zhupani, shtetas shqiptar, lindur më 31.08.1971, në Gradishtë, Lushnje, banues në adresën: godina 32, Fier-Seman, Gradishtë, Divjakë, mbajtës i kartës së identitetit nr. 027601608, ne cilesine e Ortakut qe zoteron 1 kuote qe korrespondon me 20% te kapitalit te regjistruar te shoqerise Entertajni sh.p.k.;

dhe

Z. Armando Dimo, shtetas shqiptar, lindur më 29.07.1977, në Pojan, Fier, banues në Pojan, Fier, mbajtës i kartës së identitetit nr. 024645761, ne cilesine e Ortakut qe zoteron 1 kuote qe korrespondon me 20% te kapitalit te regjistruar te shoqerise Entertajni sh.p.k. perfaqesuar me Prokure te Posacme Nr 3369 Rep, Nr 2216 Kol, date 25.09.2018 nga Z. Arben Mertiri;

Ne vijim secila prej paleve te mesiperme do te referohet veçmas si "**Shitesi**" apo "**Ortaku**", dhe se bashku si "**Shitesit**" apo "**Ortaket**".

BLERESIT:

Z. Niklovan Çela, shtetas shqiptar, lindur më 18.05.1980, ne Lushnje, banues ne adresen: Lagjia Çlirimi, Metropol Center, Lushnje, mbajtes i kartes se identitetit nr. 029862165, ne cilesine e personit te interesuar per te blere 1 kuote qe korrespondon me 40% te kapitalit te regjistruar te shoqerise Entertajni sh.p.k.;

dhe

Z. Bledar Çela, shtetas shqiptar, lindur më 14.03.1977, ne Lushnje, banues ne adresen: Lagjia Çlirimi, Metropol Center, Lushnje, mbajtes i pasaportes nr. BE8372043, ne cilesine e personit te interesuar per te blere 1 kuote qe korrespondon me 40% te kapitalit te regjistruar te shoqerise Entertajni sh.p.k.;

dhe



Z. Fatjon Latifi, shtetas shqiptar, lindur më 11.07.1984, ne Lushnje, banues ne adresen: Lagjia Çlirimi, Metropol Center, Lushnje, mbajtes i pasaportes nr. BJ7989955, ne cilesine e personit te interesuar per te blere 1 kuote qe korrespondon me 10% te kapitalit te regjistruar te shoqerise Entertajni sh.p.k;

dhe

Z. Eris Kerçuku, shtetas shqiptar, lindur më 06.05.1985, ne Lushnje, banues ne adresen: Lagjia Loni Dhanio, Bulevardi i Palmave, Lushnje, mbajtes i kartes se identitetit nr. 024774591, ne cilesine e personit te interesuar per te blere 1 kuote qe korrespondon me 10% te kapitalit te regjistruar te shoqerise Entertajni sh.p.k.

Ne vijim secili prej Z. Niklovan Çela, Z. Bledar Çela, Z. Fatjon Latifi dhe Z. Eris Kerçuku do te referohet veçmas si "**Bleresi**" dhe se bashku si "**Bleresit**".

Ne vijim Shitesit dhe Bleresit do te referohen se bashku si "**Palet**" dhe veçmas si "**Pala**".

MEQENESE:

- (A) Shitesit jane pronaret e 4 kuotave qe perfaqesojne 100% te kapitalit te shoqerise Entertajni sh.p.k., nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e themeluar sipas ligjeve te Shqiperise, e regjistruar prane Regjistrimit Tregtar me numer Regjistrimi NUIS L82121018S, me date 21.09.2018 me seli ne adresen Njësia Bashkiake Nr. 5, Rruga Perlat Rexhepi, Pallati Nr. 6, Ap. 3, Nr. Pasurie 4/73+1-4, Zona kadastrale Nr. 8270, Tiranë, Shqipëri, kapitali i regjistruar i se ciles eshte i barabarte me 21,340,400.00 Leke ("**Shoqeria**");
- (B) Z. Arben Mertiri zoteron 1 (nje) kuote qe korrespondon me 40% te kapitalit te regjistruar te Shoqerise, e barazvlefshme me 8,536,160 (tetë milion e pesëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) Lekë; Z. Arben Nazeraç zoteron 1 (nje) kuote qe korrespondon me 20% te kapitalit te regjistruar te Shoqerise, e barazvlefshme me 4,268,080 (katër milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëdhjetë) Leke; Z. Artan Zhupani zoteron 1 (nje) kuote qe korrespondon me 20% te kapitalit te regjistruar te Shoqerise, e barazvlefshme me 4,268,080 (katër milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëdhjetë) Leke; dhe Z. Armand Dimo zoteron 1 (nje) kuote qe korrespondon me 20% te kapitalit te regjistruar te Shoqerise, e barazvlefshme me 4,268,080 (katër milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëdhjetë) Leke;
- (C) Shitesit deshirojne te shesin Kuotat e tyre tek Bleresit dhe Bleresit deshirojne dhe pranojne te blejne Kuotat nga Shitesit. ("**Transaksioni**").

Palet rane dakord te nenshkruajne kete Kontrate (siç eshte percaktuar ne vijim) ne perputhje me afatet dhe kushtet e mëposhtme.

Neni 1 Perkufizime

Kur nuk përkufizohen ndryshe ne këtë Kontrate, Palet bien dakord për përkufizimet e mëposhtme të termave të përdorura më poshtë në tekstin e kësaj Kontrate:

"**Kontrate**" do te thote kontrata e shitblerjes se kuotave ne vijim, duke perfshire deklarimet, anekset dhe te gjithë ndryshimet e nevojshme dhe shtesat te pergatitura me shkrim dhe te nenshkruara nga te dyja Palet.



"Asetet" do te thote çdo dhe te gjitha asetet e listuara ne Aneksin 2, Raporti i Vleresimit te Aseteve.

"Data e Nenshkrimit" do te thote data e nenshkrimit te kesaj Kontrate nga Palet.

"Shoqeria" ka kuptimin qe percaktohet ne piken (A).

"Kursi i Kembimit" do te thote kursi i kembimit Euro/Leke i publikuar nga Banka e Shqiperise ne ditën e kryerjes se pageses se çdo shume te pagueshme sipas kesaj Kontrate.

"Çmimi i Blerjes" do te thote çmimi total i blerjes se Kuotave, qe i nenshtrohet rregullimit sipas kesaj Kontrate, i barabarte me nje shume maksimale prej 180,000.00 (njeqind e tetedhete mije) Euro, i paguar ne perputhje me kushtet dhe afatet e parashikuara ne kete Kontrate.

"Shitesit" ka kuptimin qe percaktohet ne pjesen hyrese te kesaj Kontrate.

"Ortak" ka kuptimin qe percaktohet ne pjesen hyrese te kesaj Kontrate.

"Kuotat" do te thote kater kuota qe perfaqesojne 100% te kapitalit te regjistruar te Shoqerise; nje kuote zoterohet nga Z. Arben Mertiri, e cila korrespondon me 40% te kapitalit te regjistruar te Shoqerise bashke me gjithë te drejtat e lidhura me te; nje kuote zoterohet nga Z. Arben Nazeraj e cila korrespondon me 20% te kapitalit te regjistruar te Shoqerise bashke me te gjithë te drejtat e lidhura me te; nje kuote zoterohet nga Z. Artan Zhupani, e cila korrespondon me 20% te kapitalit te regjistruar te Shoqerise bashke me gjithë te drejtat e lidhura me te; dhe nje kuote zoterohet nga Z. Armando Dimo, e cila korrespondon me 20% te kapitalit te regjistruar te Shoqerise bashke me gjithë te drejtat e lidhura me te.

"Procesverbali i Dorezimit" do te thote lista e asetëve te Shoqerise, te inspektuara nga perfaqesuesit e Bleresit ne lidhje me kushtet dhe gjendjen e tyre te punes, nenshkuar nga administratori i Shoqerise dhe Shitesit brenda 20 diteve pas Dates se Nenshkrimit.

"Rregullim" ka kuptimin qe percaktohet ne nenin 3.2.

Neni 2

Shitja e Kuotave

2.1 Sipas kushteve dhe Çmimit te Blerjes te parashikuar ne kete Kontrate, Shitesit i shesin Bleresve dhe Bleresit blejne prej Shitesve, Kuotat e zoteruara nga Shitesit ne Shoqeri.

2.2 Ne Daten e Nenshkrimit, Shitesit i shesin Bleresve dhe Bleresit blejne 4 (kater) kuota qe perfaqesojne 100% te kapitalit te regjistruar te Shoqerise, si vijon:

2.2.1 Ortaku **Z. Arben Mertiri** shet dhe transferon 100% te titullit te plote te pronesise mbi 1 (nje) kuote qe ai zoteron ne kapitalin e Shoqerise, dhe qe korrespondon me 40% te kapitalit te Shoqerise tek **Z. Niklovan Çela**, sipas kushteve dhe afateve qe percaktohen ne kete Kontrate.

2.2.2 Ortaku **Z. Arben Nazeraj** shet dhe transferon 100% te titullit te plote te pronesise mbi 1 (nje) kuote qe ai zoteron ne kapitalin e Shoqerise, dhe qe korrespondon me 20% te kapitalit te Shoqerise tek **Z. Bledar Çela**, sipas kushteve dhe afateve qe percaktohen ne kete Kontrate.



2.2.3 Ortaku **Z. Armando Dimo** shet dhe transferon 100% te titullit te plote te pronesise mbi 1 (nje) kuote qe ai zoteron ne kapitalin e Shoqerise, dhe qe korrespondon me 20% te kapitalit te Shoqerise tek **Z. Bledar Çela**, sipas kushteve dhe afateve qe percaktohen ne kete Kontrate

2.2.4. Ortaku **Z. Artan Zhupani** shet dhe transferon 10% te titullit te plote te pronesise mb 1 (nje) kuote qe ai zoteron ne kapitalin e Shoqerise, dhe qe korrespondon me 20% te kapitalit te Shoqerise perkatesisht 50% tek **Z. Fatjon Latifi**, dhe 50% tek **Z. Eris Kerçuku**, sipas kushteve dhe afateve qe percaktohen ne kete Kontrate.

2.3 Ne Daten e Nenshkrimit, me pagimin e Çmimit te Blerjes sipas nenit 3.1 me poshte, Shitesit do te transferojne 100% te titullit te pronesise mbi te gjithe Kuotat bashke me te gjithe te drejtat e tjera te votes dhe te drejtat e dividendit, dhe Bleresit do te fitojne titull te plote pronesie mbi Kuotat.

2.3.1 Pas transferimit te titullit te pronesise mbi Kuotat bashke me te gjithe te drejtat e tjera te votes dhe te drejtat e dividendit, nga Shitesit tek Bleresit, **Z. Niklovan Çela** do te zoteroje 1 (nje) kuote te kapitalit te Shoqerise dhe qe korrespondon me 40% te kapitalit te Shoqerise; **Z. Bledar Çela** do te zoteroje 1 (nje) kuote te kapitalit te Shoqerise dhe qe korrespondon me 40% te kapitalit te Shoqerise; **Z. Fatjon Latifi** do te zoteroje 1 (nje) kuote te kapitalit te Shoqerise dhe qe korrespondon me 10% te kapitalit te Shoqerise; **Z. Eris Kerçuku** do te zoteroje 1 (nje) kuote te kapitalit te Shoqerise dhe qe korrespondon me 10% te kapitalit te Shoqerise.

Neni 3

Çmimi i Blerjes

3.1 Çmimi i Blerjes do te paguhet nga Bleresit brenda 20 (njetzet) diteve pune nga Data e Nenshkrimit. Brenda 20 diteve nga Data e Nenshkrimit, administratori i Shoqerise, Shitesit dhe Bleresit do te kryejne dhe perfundojne Proçesverbalin e Dorezimit.


3.2 Çmimit te Blerjes do te pershtatet duke zbritur shumen e çdo detyrimi te Shoqerise, duke perfshire por pa u kufizuar, te ardhurat e parealizuara, taksat e papaguara, penalitetet, pretendimet e paleve te treta dhe/apo detyrime te tjera te Shoqerise dhe/apo Shitesve te lidhura me Shoqerine ose me Asetet ose me Shitesit duke perfshire por pa u limituar ne çdo humbje qe rezulton nga ndonje diference ne vlere midis aseteteve te listuara dhe vleresuara ne Raportin Vleresimit te Aseteve dhe vleres se Aseteve te listuara ne Proçesverbalin e Dorezimit ("**Rregullimi**").

3.3 Çmimi i Blerjes perfshin çdo dhe te gjitha kostot, tarifat dhe taksat ne lidhje me shitjen e Kuotave, te cilat do te jene per llogari te Shitesve dhe Shitesit nuk kane, as ne kohen e ekzekutimit te kesaj Kontrate, dhe as nuk do te ngrene ne ndonje kohe ne te ardhmen, ndonje pretendim tjeter per pagese kundrejt Bleresve.

3.4 Ne baze te dispozitave te Ligjit Nr. 8438 "Per Tatimin mbi te Ardhurat", date 28.12.1998, i ndryshuar, Shitesit do te jene pergjegjes per detyrimet e tyre tatimore qe burojne nga ky Transaksion. Bleresit do te mbajne tatimin mbi te ardhurat te shumes qe rezulton nga diferenca midis vleres nominale te Kuotave dhe Çmimit te Blerjes dhe do ta paguajne ate ne organin tatimor ne emer te Shitesve, ne leke, sipas Kursit te Kembimit, ne baze te legjislacionit fiskal Shqiptar ne fuqi. Tatimi i mbajtur ne burim mbi te ardhurat personale, siç percaktohet me ligj, do te llogantet dhe mbahet respektivisht dhe proporcionalisht nga çdo shume qe i paguhet secilit prej Shitesve.

Neni 4

Deklarimet dhe Garancite e Shitesve dhe detyrime te tjera



4.1 Nenshkrimi i kesaj Kontrate dhe plotesimi nga Shitesit i te gjitha kushteve dhe detyrimeve te parashikuara ne kete Kontrate, nuk eshte ne kundërshtim dhe nuk perben shkelje te ndonje kontrate, marreveshje, urdhri, ose ndonje vendimi gjyqesor, apo vendimi te ndonje autoriteti shteteror, vendas apo te huaj, qe ka juridiksion mbi Shitesit ose Shoqerine, ose te ndonje angazhimi tjetër ne te cilin Shitesit jane pale.

4.2 Shitesit bashkarisht dhe veçmas deklarojne, konfirmojne dhe garantojne se kapitali i autorizuar dhe i emetuar i Shoqerise eshte emetuar dhe eshte paguar apo jane kredituar si te paguar plotesisht.

4.3 Shitesit bashkarisht dhe veçmas garantojne Bleresit se Kuotat dhe Asetet jane blere ne menyre te rregullt e ligjore dhe jane nen pronesine e tyre te pakontestueshme, te lira nga çdo lloj barre, pengu, hipoteke, apo mjete te tjera garancie dhe/ose pretendime nga pale te treta, dhe jane lirisht te tregtuesheme dhe te transferueshem.

4.4 Shitesit deklarojne dhe garantojne, ne emer te tyre dhe te Shoqerise, se nuk ka procese gjyqesore aktuale apo te mundshme kunder Shitesve lidhur me Kuotat, Asetet ose kunder Shoqerise si dhe nuk ka patur asnje vendim gjyqesor apo administrativ apo ndonje afat kohor te vendosur nga ndonje organ publik/privat, qe i imponon Shitesve ose Shoqerise nje detyrim i cili mundet te kete ne te ardhmen pasoja te pafavorshme per Transaksionin e parashikuar dhe rregulluar nga kjo Kontrate.

4.5 Ne Daten e Nenshkrimit, Shitesit do t'i dorezojne Bleresit, Anekset e listuara si ne vijim:

Aneks 1: Statuti;

Aneks 2: Raporti i Vleresimit te Aseteve;

Aneks 3: Akti i Themelimit;

Aneks 4: Vendimi i Asamblese se Ortakeve per miratimin e shitjes se Kuotave dhe ekzekutimin e kesaj Kontrate;

Aneks 5: Procesverbal i kalimit te pronesise se asetëve.

Shitesit deklarojne dhe garantojne se i gjithë informacioni i dorezuar tek Bleresit, duke perfshire por pa u kufizuar ne vleren e Aseteve eshte i sakte dhe i vertete.

4.6 Shitesit deklarojne dhe garantojne se Shoqeria nuk ka detyrime ne lidhje me tatimet/taksat, tarifat e licences, ose detyrime te tjera ndaj paleve te treta dhe bien dakord se perveç formave te tjera te kerkimit te te drejtave, Bleresit kane te drejten e kompensimit te vleres se detyrimeve qe i ngarkohen Bleresve apo Shoqerise.

4.7 Ne rast se pas Dates se Nenshkrimit te kesaj Kontrate, do te ngarkohen apo do te ngrihen pretendime apo detyrime ndaj Shoqerise ose Bleresve (duke perfshire pa u kufizuar ne taksa, gjoba apo pretendime te paleve te treta), ne lidhje me Shitesit ose Shoqerine ose Asetet per periudhen para Dates se Nenshkrimit ose te lidhura me transferimin e Kuotave dhe/ose te Aseteve ne Daten e Nenshkrimit, Shitesit do te jene pergjegjesit e vetem per te tilla pretendime dhe detyrime dhe bashkarisht dhe veçmas do te demshperblejne Shoqerine dhe Bleresit per te gjithë keto pretendime dhe detyrime dhe kostot e lidhura me to.

4.8 Shitesit, ne menyre solidare dhe te përvokueshme, do te mbajne Bleresit te pademtuar dhe do ti demshperblejne plotesisht ne rast demit te shkaktuar (ku perfshihet pa u kufizuar demit, fitimi i munguar, cdo shpenzim apo kosto duke perfshire tarifat e avokateve) per shkak te nje apo cdo shkelje te deklaratave dhe



garancive te dhena ne paragrafet me siper, si dhe te cdo neni tjetër te kesaj Kontrate, ne lidhje dhe veçanerisht pa u kufizuar me Asetet dhe/ose Kuotat.

Neni 5

Deklarimet dhe Garancite e Bleresit

5.1 Ekzekutimi, i kesaj Kontrate nga Bleresit eshte i vlefshem dhe ne asnje rast nuk do te rezultojne ne ndonje shkelje, apo pavlefshmeri sipas ndonje marreveshje, kontrate apo gjykimi ne te cilin Bleresit jane pale ose jane pale e detyruar, dhe mospermbushja e te cilave do te ndikonte negativisht ne aftesine e Bleresve per te permbushur kushtet e kesaj Kontrate.

Neni 6

Ndalimi i Konkurrences

6.1 Per nje periudhe prej 5 (pese) vjetesh nga Data e Nenshkrimit, Shitesit dhe perfaqesuesi ligjor i Shoqerise garantojne se ata vete, anetaret e familjes se tyre, personat e lidhur me ta apo perfaqesuesit e tyre, direkt apo indirekt, nuk do te krijojne dege te Shoqerise, nuk do te zoterojne, menaxhojne, angazhohen, veprojne, kontrollojne, punojne, te konsultojne, kryejne sherbime, bejne biznes, mbajne ndonje interes (proniesie, financiar ose tjetër) ose nuk do te marrin pjese ne zoterimin, menaxhimin, operimin ose kontrollin e ndonje biznesi, prone, qofte ne forme shoqerie, proniesie apo partneriteti, ose tjetër, qe ka lidhje me aktivitetin e televizionit kabllor, dhe telekomunikacionit ne Shqiperi.

6.2 Pervec çdo dhe te gjitha mjeteve tjera në dispozicion të Bleresve, Shitesit, do te jene pergjegjes dhe do t'i paguajne Bleresve nje demshperblim prej 150,000 (njqind e pesedhjetë mijë) Euro per çdo shkelje te dispozitave te paragrafeve 7.1.

Neni 7

Te ndryshme

7.1 Kjo Kontrate perben marreveshjen e plote te Paleve dhe zevendeson çdo marreveshje te meparshme verbale ose ne forme te shkruar midis Paleve. Kontrata hyn ne fuqi ne Daten e Nenshkrimit.

7.2 Çdo ndryshim ne kete Kontrate do te jete i vlefshem vetem nese do te behet me shkrim dhe do te nenshkruhet nga ose ne emer te seciles Pale.

7.3 Kjo Kontrate bazohet ne legjislacionin shqiptar ne fuqi ne Republiken e Shqiperise ne momentin e nenshkrimit te Kontrates. Per çeshtjet e parregulluara shprehimisht nga kjo Kontrate do te zbatohen dispozitat e Kodit Civil Shqiptar dhe Ligji nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar.

7.4 Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane do te jete kompetente per te zgjidhur çdo mosmarreveshje apo çeshtjet qe Palet nuk mund t'i zgjidhin me mirekuptim dhe bisedime me njera tjetren.

7.5 Te gjitha shpenzimet dhe tarifat noteriale te lidhura me nenshkrimin e kesaj Kontrate si dhe te tjera shpenzime para institucioneve te ndryshme shtetore te lidhura me regjistrimin e transaksionit sipas kesaj Kontrate do te paguhet nga te dyja Palet ne pjese te barabarta.

7.6 Te gjitha komunikimet dhe njoftimet mes Paleve lidhur me kete Kontrate do te behen me shkrim dhe do te dergohen ne adresat e zgjedhura nga palet per qellime te komunikimit mes tyre, si me poshte:



Shitesit:
Z. Arben Mertiri
Kolonje
Lushnje, Shqiperi

Bleresit:
Z. Niklovan Çela
Lagjia Çlirimi,
Metropol Center,
Lushnje, Shqiperi

Kjo Kontrate eshte pergatitur dhe nenshkruar ne gjuhen Shqipe ne 4 (kater) kopje origjinale.

[FAQJA VIJUESE ME NENSHKRIMET E PALEVE]




Tirane, me 02/10/2018

SHITESIT

Z. Arben Mertiri

Arben Mertiri


Z. Arben Nazeraç

Arben Nazeraç


Z. Artan Zhupani

Artan Zhupani


Z. Armando Dimo


Perfaqesuar me prokure nga
Arben Mertiri

Arben Mertiri


SHITESIT


BLERESIT

Z. Niklovan Çela


Niklovan Çela


Z. Bledar Çela

Z. Fatjon Latifi

Fatjon Latifi


Z. Eris Kerçuku

Eris Kerçuku


LISTA E ANEKSEVE

Aneksi 1:	Statuti
Aneksi 2:	Raporti i Vleresimit te Aseteve
Aneksi 3 :	Akti i Themelimit
Aneksi 4 :	Vendim i Asamblese se Ortakeve per miratimin e shitjes se Kuotave dhe ekzekutimin e kesaj Kontrate.
Aneksi 5:	Procesverbal i kalimit te pronesise se asetave

